



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:168447

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05413503

P.nr.890/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL gjyqtari i vetëm gjykues Refki Piraj, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Arbnijsë Gashi, në lëndën penale, kundër të akuzuarit A:M., nga Prizreni, Rr.“.....” nr., me numër personal, për shkak të veprës penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragraf. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren PP/II. nr. 1346-9/23 të datës 08.09.2023, në praninë e prokurorit të shtetit Beqë Shala, të akuzuarit A:M., dhe mbrojtësit të tij avokatit Afrim Paçarizi, me datë 25.01.2024 mori dhe shpalli publikisht, ndërsa përpiloi me shkrim me datë 26.02.2024 këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuarit:

A:M., nga i atidhe e ëma, mbiemri i vajzërisë së nënës, i lindur me datë, në Prizren, ku dhe jeton, në rrugën ‘.....nr....., i pamartuar, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 05.08.2023, rreth orës 19:00, në Prizren në rr. “Remzi Ademaj”, i shkakton lëndim të lehtë trupor dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin të dëmtuarit A.M., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje momentale, derisa i dëmtuari ishte duke udhëtuar si pasagjer në veturën e djalit të tij, në një moment i pandehuri e rrezikon komunikacionin, ku i dëmtuari e hap dritaren e veturës duke i thënë të pandehurit “na rrezikove”, pastaj i pandehuri fillimisht e fyen duke e sharë dhe ofenduar, dhe në momentin kur i dëmtuari del nga vetura që të sqarohet, i njëjti e sulmon fizikisht duke goditur me grushte në pjesën e kokës, me ç ‘rast i shkakton lëndime të lehta trupore si: ndrydhja të indeve të buta në regjionin zverkor, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), lëndime këto të konstatuara në mendimin e ekspertizës – mjeko- ligjor të Dr. F.B., , të datës 07.08.2023.

Me këto veprime ka kryer veprën penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragraf. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata ne kuptim te nenit 7, 17, 21, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 185 par.1 nën par.1.4 si dhe neneve 364 dhe 365 të KPPRK-së të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej treqind (300) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me të holla nuk mund të paguhet nga ana e të akuzuarit në afatin ligjor, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, duke llogaritur pesëmbëdhjetë (15) euro, për një (1) ditë burgim.

I dëmtuari A.,M., nga Prizreni, me banim në rrugën “” nr. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike gjykata e udhëzon në kontest të rregullt juridiko-civil.

Obligohet i akuzuari që ti paguajë te gjitha shpenzimet e procedurës penale në bazë të llogarisë se gjykatës, në emër te paushallit gjyqësor te paguaj shumen prej 20,00 euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore shumën prej 20.00 dhe në emër të ligjit mbi mbrojtjen e viktimave të kimit shumën prej 20,00 euro, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzën PP/II. nr. 1346-9/23 të datës 08.09.2023, ndaj të akuzuarit, A:M., nga Prizreni, për shkak te veprës penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragraf. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Gjykata në këtë çështje penale ka mbajtur shqyrtimin gjyqësor në disa seanca në të cilën in akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Në fjalën përfundimtare prokurori i shtetit ka theksuar se nga administrimi i provave dhe shqyrtimeve gjyqësore të mbajtura me datë 28.12.2023 dhe 24.01.2024, është vërtetuar në tërësi gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës. Nga dëshmia e të dëmtuarit – dëshmitari A.M., , e dëshmitarit A.M., në detaje veprimet e të pandehurit ditën që është zhvilluar ngjarja. Nga deklarata e të pandehurit të dhënë në prokurori me datë 06.08.2023, në mënyrë të pa kontestuar i pandehuri pranon fajësinë dhe shpreh pendimin për veprën penale. Edhe nga faktet dhe provat tjera siç janë raporti mjekësor si dhe ekspertiza mjekoligjore e dt. 07.08.2023 përshkruhen natyra, dhe karakteri i lëndimeve trupore te të i dëmtuarit. Andaj i ka propozuar gjykatës që i pandehuri të shpallet fajtor dhe dënohet sipas ligjit, si dhe gjykata ti ket parasysh rrethanat lehtësuese dhe renduese me rastin e matjes së dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.A.P.; në fjalën përfundimtare ka theksuar se pas adminsitrimit të provave dhe analizave të së njëjtave, siç janë dëshmia e dëshmitarit A.M., të dëmtuarit – dëshmitarit A.M., dhe te akuzuarit, u vërtetua kategorikisht deklaratat kontradiktore të dëshmitarit A.M., si dhe të dëmtuarit – dëshmitarit A.M.,]. Kjo për faktin se dëshmitari A.M., në deklaratën e dhënë në prokurori me dt. 08.09.2023, ndër të tjera ka deklaruar “drejtuesi i motoçikletës e ka goditur me grusht në kokë” ndërkaq në procesverbalin e dt. 28.12.2023 i dëmtuari – dëshmitari A.M., deklaroi se i akuzuari më ka goditur 5-6 here në kokë, ndërkaq dëshmitari A.M., në pyetjen e prokurorit se a mund te na tregoni ku ka ndodhur sulmi dëshmitari A.M., përgjigjet “babai i im ka qenë veç i dalë nga vetura dhe kështu i akuzuari e ka goditë me grusht më shumë se një herë nuk e di sa” pra nëse i marrim këto tri

deklarata dhe i ballafaqojmë siç janë deklarata e dhënë në prokurori dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor shihet qartë se këto deklarata janë kontradiktore në mes vete dhe se nuk e pasqyrojnë të vërtetën. Sa i përket faktit që i mbrojturi i tij në deklaratën e dhënë në prokurori, i cili në pyetjen e prokurorit se a e pranon fajësinë ku i njëjti deklaroi se ndihet fajtor, nga pikë vështrimi i mbrojtjes, gjykata këtë pranim të fajësisë i cili është bërë para administrimit të provave nuk duhet ta marrë për bazë, por duhet të fokusohet në tre deklaratat e këtu të pandehurit i cili ka qenë konsistent dhe nuk i ka ndryshuar deklaratat e dhëna me pare. Nga sa u tha më lartë mbrojtja është e bindur se veprimet e këtu të pandehurit e përjashtojnë kundërligjshmërinë e veprës penale, sepse këto veprime kanë të bëjnë me mbrojtje të nevojshme pasi që i njëjti i është nënshtruar një sulmi të atëçashëm, me çrast nga frika se duhet të pësoj goditje ka reaguar dhe të dëmtuarin e ka goditur një herë me grusht në pjesën anësore të fytyrës. Si përfundim e ftoj gjykatën që ndaj këtu të pandehurit Arijonit, të nxjerra aktgjykim lirues me arsyetimin se nuk është provuar se i pandehuri ka krye veprën penale në ngarkim.

I akuzuari A.M., në tërësi e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, av. A.P.,.

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe paraqitjes dhe shqyrtimit të provave secilës veç e veç e dhe lidhjes logjike të gjithave së bashku ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 05.08.2023, rreth orës 19:00, në Prizren në rr. “.....”, i shkakton lëndim të lehtë trupor dhe përkohësisht ia dëmton shëndetin të dëmtuarit A.M., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje momentale, derisa i dëmtuari ishte duke udhëtuar si pasagjer në veturën e djalit të tij, në një moment i pandehuri e rrezikon komunikacionin, ku i dëmtuari e hap dritaren e veturës duke i thënë të pandehurit “na rrezikove”, pastaj i pandehuri fillimisht e fyen duke e sharë dhe ofenduar, dhe në momentin kur i dëmtuari del nga vetura që të sqarohet, i njëjti e sulmon fizikisht duke goditur me grushte në pjesën e kokës, me ç ‘rast i shkakton lëndime të lehta trupore si: ndrydhja të indeve të buta në regjionin zverkor, të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), lëndime këto të konstatuara në mendimin e ekspertizës – mjeko- ligjor të Dr. F.B., , të datës 07.08.2023.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar administrimi i provave në shqyrtim gjyqësor dhe atë nga deklarimi i të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit A.M., deklarimi i dëshmitarit A.M., deklaratën e të dëmtuarit/dëshmitarit: A.M., të dhënë në Prokurori me datë 17.08.2023, deklaratën e dëshmitarit: A.M., të dhënë në Polici me datë 05.08.2023, deklaratën e të pandehurit: A.M., të dhënë në Prokurori, me datën 06.08.2023, raportin mjekësor të Spitalit Rajonal në Prizren-Emergjencia: me nr. të protokollit 22318, të lëshuar me datën 05.08.2023, mendimin e eksperti mjeko-ligjor Dr. F.B., të datës 07.08.2023, fotoalbumin e realizuar nga policia dhe shkresat tjera të lëndës.

Deklarimi i dëshmitarëve në shqyrtim gjyqësor.

I dëmtuari-dëshmitari A.M., në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 28.12.2023, ka deklaruar se ditën kritike kam qenë me dy djemtë A.in dhe A.in, kemi qenë në automjetin e djalit duke lëvizë në rrugën Remzi Ademaj, në drejtim të shtëpisë tonë e cila gjendet në rrugën “ ostoki germen” “nr.4, te udhëkryqi para kuvendit komunal, i pandehuri me motoçikletë në distancë shumë të shkurtë, ka trupua rrugën, ka dalë nga rrugica e cila gjendet në Kuvendin Komunal në drejtim të urës, për fat të mirë djali ka frenuar vullshëm për mos me e godite dhe i ka ra borisë, në atë moment, i akuzuari është ndale në cep të urës kur jemi kthyer djathtas, ka

reagua i akuzuari me fjalët : “he çka nënën po doni” nga se i ka vërejte tabelat me targa te huaja. Ne i thamë se a e pa se ishim tu aksidentu, kem tu të lëndua, ka theksuar se personalisht i ka thënë këto fjalë, të tjerat nuk i kujtohen ngase janë shtyrë me fjalë dhe u bllokua komunikacioni, tutje kanë vazhduar lëvizjen te taksistet para TEB Bankës aty janë ndale, i njëjti ka ardh nga cepi i urës se paku 20m, largësi motorin e ka lënë dhe në këmbë ka ardh dhe më ka goditur me grusht në pjesën e pasme të kokës, 5-6 herë, pastaj djemtë e tij dolën nga automjeti por i akuzuari ka ikur nga vendi i ngjarjes. Përveç nesh nuk ka qenë askush tjetër i involvuar në këtë ngjarje, më tej ka theksuar se kur i pandehuri është drejtuar në drejtim të tyre, unë e kam larguar veturën prej urës me qëllim të bllokimit të komunikacionit, dhe në momentin kur kame dale nga vetura kanë pasua grushtimet. Arsyeja se pse kam dal nga vetura ka qenë, me u prezantua se jam person zyrtar dhe të vazhdojmë rrugën mos të ndodhin këto, në momentin kur e kame hape derën goditjet më kanë ardhë nga mbrapa.

Dëshmitari A.M., gjatë shqyrtimit gjyqësor me datë 28.12.2023 ka deklaruar se qëndron pranë deklaratës të dhënë në prokurori, duke shtuar se ditën kritike ka qenë në veturë duke vozitur, i akuzuari për një moment i ka prerë rrugën dhe për pak ka qenë duke e aksidentuar, i ka rënë borisë dhe iu ka drejtuar me fjalët “kadal se kesh tu të shkele” por i akuzuari na ofendoi duke na thënë “hupni se po ju q...robet”, në atë moment, janë skajuar pak përtej urës ku rrinë taksistet, ky djali e ka godite babën, babai ka dashtë me u sqarua se çka u bë, i akuzuari nuk ka prite e ka goditë dhe ka ikë. Babai ka qenë veç i dalë nga vetura dhe kështu i akuzuari e ka godite me grusht më shumë se njëherë nuk e di saktë, goditja ka qene prej mbrapa, babi nuk u rrëzua, por ka humbur orientimin, ka mohuar që pas ngjarjes ta kenë ndjekur të akuzuarin deri tek IPKO, dhe nuk është e vërtet që i akuzuari na ka kërkuar falje, po i njëjti na ka sharë me rob.

Nga leximi në deklartën e të dëmtuarit/dëshmitarit A.M., të dhënë në Prokurori me datë 17.08.2023, vërtetohet se, ditën kritike me datë 05.08.2023 rreth orës 19:00 është sulmuar fizikisht nga i pandehuri duke e goditë me grusht dhe i ka shkaktuar lëndime trupore, i njëjti është larguar nga vendi i ngjarjes duke e lënë motoçikletën në atë vend.

Nga leximi i deklaratës së dëshmitarit A:M., të dhënë në Polici me datë 05.08.2023, vërtetohet se, ditën kritike derisa ka qenë me të dëmtuarin me veturë kur ka arritur në rr. “Remzi Ademaj” gjatë drejtimit të veturës derisa ka ndërmarrë veprimin që të kthehet djathtas në rr. “.....” drejt bankës “TEB” në udhëkryq ka ardhur një motorist nuk ndalet dhe i del para veturës pastaj e ka frenuar veturën e tij dhe aty e kam ndalur veturën dhe drejtuesi i motoçikletës ka filluar të shaj me fjalë të ndryshme pastaj prindi- i dëmtuari A.M., ka reaguar dhe duke dalë nga vetura ky personi – drejtuesi i motoçikletës e ka goditur me grusht në kokë, më pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes.

Nga leximi i deklaratës së të pandehurit A:M., të dhënë në Prokurori me datë 06.08.2023, vërtetohet se, ditën kritike ka ndodhur një mosmarrëveshje me të dëmtuarin A.M., të cilin nuk e kam njohur fare, mosmarrëveshja ka qenë për shkak të një gabimi në komunikacion dhe e ka sulmuar të dëmtuarin A.M., për të cilin rast është penduar që ka ndodhur, por ajo ka qenë për shkak të një nervoze momentale.

Nga leximi i raportit mjekësor të Spitalit Rajonal të Prizrenit- Emergjencia me nr të protokollit 22318, të lëshuar me datë 05.08.2023, vërtetohet që i njëjti ka marrë trajtim pas rastit të sulmit fizik, i goditur me grushte në regjionin zverkut, i njëjti ka ndjerë dhembe, marramendje, i trullësuar dhe i shqetësuar.

Nga ekspertiza mjeko-ligjore e datës 07.08.2023, të dr. F.B., gjykata ka vërtetuar natyrën edhe karakterin e lëndimeve trupore për të dëmtuarin A.M., me konstatimin se të njëjtat janë të natyrës së lehtë trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Nga shikimi në fotoalbumin vërehen fotografi të motoçikletës me targa 04-715-RD, tek disa kontinier, të përshkruar si në vendin e ngjarjes.

Përfundimet mbi faktet vendimtare (provat).

Pas administrimit të gjitha provave në shqyrtimit gjyqësor dhe leximin e provave materiale gjykata gjeti se i akuzuari është fajtor për veprën penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragraf. 1 nën par. 1.4 të KPPRK-së, përfundimi i gjykatës se i akuzuari është fajtor për veprën penale të lartcekur, është vërtetuar nga administrimi i provave, nga deklarimi i të dëmtuarit A.M., i cili e thekson faktin se fillimisht i akuzuari i është drejtuar me fjalët “he çka nënën po doni”, dhe në momentin që ka dal nga vetura i njëjti e ka goditur 5-6 herë me grushte, deklarimi i të dëmtuarit për gjykatën është i besueshëm sepse edhe gjatë deklarimit në polici ka theksuar të njëjtat fakte e poashtu deklarimi i tij është në harmoni edhe me atë të dëshmitarit A. dhe provave materiale. Poashtu faktin se i akuzuari ka goditur të dëmtuarin A., e ka theksuar edhe dëshmitari A. M., për çka edhe gjykata i beson plotësisht sepse edhe në deklarimet e mëparshme dhënë në prokurori por edhe shqyrtim gjyqësor ka theksuar se deri sa ka qenë në veturë duke vozitur, i akuzuari për një moment i ka prerë rrugën dhe për pak ka qenë duke aksidentuar, i ka rënë borisë dhe iu ka drejtuar me fjalët “kadal se kesh tu të shkele” por i akuzuari i ka ofenduar duke i thënë “hupni se po ju q...robet”, në atë moment, janë skajuar pak përtej urës ku rrinë taksistët, ky djali (duke ju referuar të akuzuarit) e ka godite babën, babai ka dashtë me u sqarua se çka u bë, i akuzuari nuk ka prite e ka goditë dhe ka ikë. Poashtu edhe përmes raportit mjekësor të Spitalit Rajonal të Prizrenit- Emergjencia me nr të protokollit 22318, të lëshuar me datë 05.08.2023 është vërtetuar fakti se atë ditë i dëmtuari A.M., ka marr trajtim mjekësor për shkak të lëndimeve të marra nga sulmi fizik, të cilat lëndime më vonë nga ekspertiza mjeko-ligjore e datës 07.08.2023, të dr. F.B., janë konstatuar si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme, si dhe faktit që në vend ngjarje është gjetur nga policia motoçikleta e të akuzuarit A., e vërtetuar nga foto albumi, me çka është konstatuar në mënyrë të plotë gjendja faktike si në dispozitiv të aktakuzës.

Mbrojtja e të akuzuarit në shqyrtim gjyqësor.

I akuzuari në mbrojtjen e tij gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se derisa ishte duke e vozite motoçikletën ka kaluar në rrugën Remzi Ademaj, duke kalua në anën e urës aty ka dëgjuar sirenat e veturave është ndal e ka kthye kokën dhe i është kthyer personit i cili i ka rënë sirenës dhe e ka pyete çka u bë, i dëmtuari i ka thënë ngadalë se kesh tu të fluturua. Ka shtuar se i ka thënë nuk u bë asgjë sepse isha larg, por megjithatë më fal, i njëjti ka vazhduar rrugën në drejtim të urës kur më ka kalua anash me është afrua dhe prindi i vozitësit e ka qel dritaren e veturës dhe me është drejtuar “ a je ne mend, çka je tu be” dhe me ka shajt, ju ka drejtuar që mos të shan, djali i tij donte ta largohet kur ka vazhdua rrugën ka ndëgju duke i thënë djalit të tij ndalo veturën ose hup prej këtu edhe ti, ku i është ndal para motoçikletës, ka zbrit prej motoçikletës të njëjtën kohë ka dale edhe i dëmtuari nga automobili dhe i është vërsul me duar të ngritura dhe në atë moment pranon se e ka goditë me grusht një here në fytyrë, kur e kane pa djemtë e tij kanë dale nga vetura dhe atëherë kame ik nga vendi i ngjarjes më kanë ndjek deri te qebaptorja “Qaza Grill” derisa në një moment A.i u rrezua, unë e kame vazhdua rrugën. Më tej

ka theksuar se qëndron pranë deklaratës së dhënë në prokurori, të cilën e ka dhënë në prezencë të mbrojtësit të tij dhe e ka nënshkruar. I akuzuari ka shtuar se në tërësi i pranon veprimet e ditës kritike dhe se me rastin e dhënies së deklaratës nuk ka pas asnjë presion dhe deklaratën e ka dhënë me vullnet të lirë.

Deklarimit të akuzuarit gjykata i beson pasi që është deklarim i qëndrueshëm në raport me provat të tjera të administruara dhe me vetveten, i akuzuari për të ju shmangur përgjegjësisë penale e mohon kryerjen e veprës penale, por gjatë deklarimeve të tija në prokurori dhe gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor i ka pohuar të gjitha veprimet e ndërmarra në ditën kritike si dhe ka pranuar faktin që ka goditur të dëmtuarin A.M., Poashtu i akuzuari gjatë deklarimit të mëparshëm e ka pranuar veprën penale sipas gjendjes faktike të përshkruar më lartë, pra në deklarimin e tij në Prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ka theksuar se e pranon që ditën kritike ka goditur të dëmtuarin A.. Deklarimet e tij janë të vërteta dhe në pajtim edhe me provat të tjera, përveç faktit që nuk e pranon kryerjen e veprës penale me qëllim që ti shmanget përgjegjësisë penale.

Ndërsa se veprimet e ndërmarra nga i akuzuari përjashtojnë kundërligjshmërinë, për shkak se i njëjti ka vepruar kësaj ngase ka pas sulm të atëçastshëm nga i dëmtuari A., për gjykatën nuk qëndrojnë ngase nuk është vërtetuar me asnjë provë të vetme që i akuzuari A., ka qenë i sulmuar nga i dëmtuari, dhe ka vepruar në vetëmbrojtje duke e sulmuar këtu të dëmtuarin A.. Andaj gjykata ka vlerësuar se nuk ekziston asnjë rrethanë që do të përjashtonte kundërligjshmërinë, ngase veprimet e ndërmarra nga këtu i akuzuari janë të ndaluara me ligj dhe përbëjnë vepër penale.

Analizimi i veprës penale

1. Nga administrimi i provave dhe në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata erdhi në përfundim se i akuzuari është fajtor për veprën penale, Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragraf. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kualifikimi i kësaj vepre penale rrjedhë si pasojë e veprimeve dhe pasojave të shkaktuara nga i akuzuari, prandaj nga rrethanat e rastit konkret meqenëse është vërtetuar edhe gjendja faktike sipas aktakuzës së prokurorisë themelore në Prizren, rezulton se i dëmtuari ka pësuar lëndime trupore që i janë bërë nga i akuzuari që në përmbajtje lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme. Prandaj me veprimet e të akuzuarit dhe pasojat që janë shkaktuar tek i dëmtuari formohen të gjitha elementet e veprës penale Lëndim i lehtë trupor, nga neni 185 paragraf. 1 nën par. 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, paragrafi 1 thotë që *‘Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton në’* nën par. 1.4 *‘dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet’*. Prandaj sipas bindjes së gjykatës nga analizimi i kësaj dispozite del se me faktin se në këtë rast janë ndërmarr veprime fizike me të cilat është shkaktuar lëndim i lehtë trupor me pasoja të përkohshme për jetën dhe shëndetin e të dëmtuarit.

Përcaktimi për llojin dhe lartësinë e dënimit

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit të parapara si në nenin 69 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Rrethanë lehtësuese mori parasysh sjelljen korrekte të të akuzuarit gjatë procedurave gjyqësore, rrethanat personale se është i moshës së re, i gjendjes së dobët ekonomike. Si rrethana rënduese në rastin konkret për të akuzuarin gjeti shkallën e lartë të pjesëmarrjes dhe të dashjes ku i akuzuari ka vepruar me dashje direkte ka mundur ta dijë se me veprimet e tija mund të shkaktoj edhe pasoja më të rënda. Gjkata vlerëson se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i shprehur në nenin 38 të KPRK-së, ashtu që të parandaloj të akuzuarin nga veprat tjera penale si dhe personat tjerë. Të shprehet gjykimi shoqërore për veprën penale dhe forcimi i respektimit të ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor u mor në kuptim të nenit 449 dhe 451 par.1 të KPPK-së.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimin e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Vendimin mbi kërkesën pasurore-juridike është marr konform nenit 457 të KPPK-së

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i përgjithshëm
P.nr. 890/2023 me datë 26.02.2024

B. profesional
Arbnijë Gashi

Gjyqtari
Refki Piraj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë(30) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.